

Raport Narrativ Vjetor 2021

1. Progresi i Përgjithshëm Programatik


Ky dokument është konceptuar i ndarë në 3 faza përgjatë vitit 2021 për efekt raportimi koherent dhe për të shmangur realizimin e një dokumenti të rëndësishëm siç është raportimi narrativ vjetor i organizatës në mënyrë kumulative vitin pasardhës.

Janar – Prill 2021

Periudha e parë 4-mujore e ka gjetur qendrën aktive dhe alerte për të pozicionuar imazhin tek të rinjtë në Lezhë si një hapësirë ndëraktive eventesh social-kulturore. Është një fazë që e gjen qendrën në përpjekjet maksimale për konsolidim, bashkëpunim e njohje të jashtme. Fluksi i frekuentuesve të rinj ka qënë në nivele shumë më të larta krahasuar me muajt pararendës pasi vihet re familiariteti me ekzistencën e qendrës. Bashkëpunimi me një institucion si Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Luksemburgut falë rrjetëzimit të Fondit Evropian për Demokraci, një ndër donatorët e qendrës në vitin 2021, ka qënë padyshim një moment i madh arritjesh për qendrën për 2 arsye; e para sepse u dha mundësia për të testuar veten në një profil të synuar prej kohësh (aktivizmi politik) por me eksperiencë rishtazi, dhe së dyti sepse e paraqiti qendrën nën një dritë të re të audienca, pra, si një entitet që i besohet nga struktura diplomatike të vendeve të BE (duke qënë se Luksemburgu është ndër vendet themeltare të Unionit) për të përçarur nevojën e integritit të Shqipërisë tek të rinjtë. Kontaktet e anëtarëve të qendrës dhe të rinjve pjesëmarrës në zbatim drejtpërdrejt me ambasadorin e këtij vendi për vendet e Ballkanit dhe Turqinë i ka dhënë një rëndësi edhe më të madhe punës së qendrës dhe besimit të komunitetit në të. Të rinjtë e rekrutuar për të ndjekur ndërhyrjen e shkollës dimërore në studime politike dhe integrimin evropian, kanë krijuar një raport të fortë besimi me qendrën dhe një pjesë e mirë e tyre janë frekuentues të rregullt tashmë duke i dhënë qendrës një “arsenal” të mirë të rinjsh të përgjegjshëm dhe me premisa të mira aktivizmi.

Përmes shkollës dimërore në politikë dhe integrim në BE kemi synuar të formojmë pjesëmarrësit me një kulturë angazhimi në jetën politike në të ardhmen e afërt dhe për këtë duhen njohuri të mënyrës si funksionon një shtet demokratik, dhe institucionet e ligjit dhe drejtësisë së tij; po ashtu, roli që luan politika dhe ai i partive politike

Programi ishte një sukses në lidhje me cilësinë e mësimdhënies, siç citohet nga të rinjtë dhe audienat e tjera të qendrës, pasi Lezha nuk kishte provuar më parë një event të mësuar jo-formal të këtyre përmasave e që përfshinte një grup kaq të dinamik profesionistësh dhe akademikësh. Pamë me kënaqësi se si prindër i afroreshin qendrës dhe shprehnin habinë dhe mirënjohjen për ekspozimin e fëmijës së tyre ndaj përvojës. Ndërhyrja ishte ndër përvojat më të rëndësishme brenda programit të qendrës rinore. Politika, zhvillimi politik dhe tema e integritit në BE janë çështje të ndjeshme në vend të cilat konsiderohen probleme për "të rriturit", duke dekurajuar pjesëmarrjen e të rinjve dhe kuptimin e ligjërit politik.




Po ashtu, angazhimi në procesin zgjedhor ishte një tjetër moment kyç i ndodhur gjatë kësaj periudhe. Një sfidë madhore që u ndërmor me synimin për ta forcuar poziten e OJF-së në të njëjtën fushë të aktivizmit politik. Janë më pak se 2 vite nga momenti i hapjes së qendrës ndaj nuk mund të konsiderohet se kemi arritur pjekurinë profesionale në nismat më lart por një hap solid drejt kësaj fushe. Është e rëndësishme për ne mos të mbesim vetëm në nivelin e organizimit të eventeve social kulturore me qëllim primar argëtimin apo kalimin e kohës së lirë të të rinjve që frekuentojnë. Ndonëse tanimë H.A.N.A njihet në Lezhë e më gjërë si qendër aktive rinore që kërkohet në bashkëpunim, mbetet qëllim në vetvete përpjekjet për aktivizëm të mirëfilltë rinor përmes krjimit të grupeve me të rinj që dinë të reagojnë e advokojnë më zërin e tyre.

Bashkëpunimi dhe rritja e portofolit të projekteve ka qënë një pikë e rëndësishme e kësaj fazë të zbatimit. Kështu, 2 projekte të reja (MFA Luksemburg & Leviz Albania) kanë qënë nxitje e optimizëm për qëndrueshmërinë e rritjen e qendrës ndonëse për periudha jo të gjata kohore. Bashkëpunimi me KRIIK Albania për vëzhgimin e zgjedhjeve dhe informimin e të rinjve që votojnë për herë të parë po ashtu ka mbajtur qendrën të motivuar për të përfutur nga eksperiencia e tjerëve dhe ofruar një shërbim shtesë që e konsiderojmë hap të sigurt edhe drejt pozicionimit si hapësirë aktivizmi politik në shoqërinë civile të Lezhës.

Një aspekt tjetër shumë i rëndësishëm për ne ka qënë vendimi për të prezantuar tek të rinjtë teatrin si mënyrë shprehjeje ndaj problemeve të shoqërisë, ato të lidhura me luftën e vajzave/grave për trajtim të barabartë. Është punuar me 2 grupe të rinjsh të moshave 15-17 vjeç për të vënë në skenë një shfaqje, origjinale ose të krijuar enkas për ta duke marrë shkas nga ngjarjet në vend kundër jetës dhe lirisë së vajzës dhe gruas, patriarkalizmit, stigmës dhe diskriminimit gjinor. Shfaqja quhet “Ri-edukimi i Apolonit” dhe po finalizohet nxitur nga shkëndijat fillestare në muajin Dhjetor gjatë fushatës së 16 ditëve të aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore (OKB). Kemi parë se si kjo formë shprehie (teatri) është manifestim emocionues i rebelimit dhe rritjes së vetë-besimit të të rinjve dhe aftësive të tyre për të bashkëpunuar e bashkëvepruar me njëri tjetrin. Është pa dyshim një fushë që dëshirojmë ta eksplorojmë më tepër pasi rezultatet janë shpresëdhënëse dhe të prekshme në kohë të shkurtër. Gjatë Majit 2021, shfaqja do të jetë gati dhe do të vihet në skenë për herë të parë për publikun Lezhjan e më pas do të synohet një tur ndër bashkëpunëtorë.

Bashkëpunim tjetër që ka kryer qendra gjatë kësaj periudhe është me qëllim për të replikuar në Lezhë klubin rinor të quajtur “Bëhu Burrë” (nga rrjeti Young Men Initiative) të cilin e ka pilotuar gjatë muajve Tetor-Dhjetor dhe po e zbaton gjatë vitit 2021. Ndërkohë që është një mundësi tepër e mirë për të ekspozuar të rinjtë ndaj diskursit të dhunës me bazë gjinore, është edhe mundësi për të vlerësuar një kurrikulë të ngritur nga ekspertë të shumtë që e kanë akredituar dhe sot replikohet lehtë nga profesionistë të shkencave sociale e të komunikimit. Nuk është një projekt i shoqëruar me buxhet por është një mundësi për të shkuar tsek të rinjtë të pajisur me instrumente funksionale e të strukturuar. 15 të rinj janë pjesë e këtij klubi dhe është zgjedhur një komunitet rural pasi kemi dashur tqë arrijmë edhe të rinj që nuk aksesojnë dot qendrën fizikisht. Ka shumë mangësi të të kuptuarit të roleve gjinore nga ta që reflektohen në sesione, pasojë e një bombardimi afat-gjatë nga praktika të dëmshme në familje, shkollë e shoqëri (mos-trajtimi akut i temave të kësaj natyre me këtë kategori), por pikërisht për këtë arsye insistojmë për ta çuar në fund diskutimin me ta sipas modulit të akredituar.



Gjatë Prillit, qendra ka pasur vizita dhe ekspozime të shumta e të rëndësishme institucionale nga përfaqësi e OSBE (Ambasadorja e misionit të vëzhgimit në vend; përfaqësi e Ambasadës Britanike; takim virtual me 5 Ambasadorë të BE në vend, përfshirë Ambasadorin Luigi Soreca). Janë konsideruar si çaste të rëndësishme sepse është parë vlerësim për ekzistencën dhe punën e H.A.N.A duke larguar vëmendjen nga problemet e qëndrueshmërisë së të ardhurave për të ardhmen për një moment e menduar se mund të ketë struktura që do të jenë të gatshme me gjasë për ta mbështetur qendrën për ti qëndruar identiteti që ka mundur të krijojë në Lezhë.

Po ashtu, një tjetër aspekt i zbatimit të programit të qendrës gjatë kësaj periudhe ka qënë këndi social ku janë organizuar evente si pasdite kinemaje, pasdite lojërash, pasdite kulturore, klub libri dhe ekspozitë. Një aspekt i rëndësishëm i mbarëvajtjes së qendrës është aftësia për të qënë aktive me evente për të rinjtë të cilët nuk kanë mundësi të bëjnë pjesë e grupeve më lart por duan një lloj tjetër angazhimi brenda qendrës. Kjo ka qënë mundësia për ti afruar këtë kategori apo për të ofruar një alternativë pjesëmarrjeje për të rinjtë që vinë për tu bërë pjesë e grupeve të punës të përshkruara më lart.


Maj – Gusht 2022

H.A.N.A ka zbatuar aktivitete që kanë kontribuar në misionin e saj që të shërbejë si ndërlidhese e mundësive me potencialet rinore në Lezhë duke u fokusuar në 3 drejtime kryesore që gradualisht janë kthyer në objektivat madhorë të qendrës për vitin 2021 dhe do të ushqejnë programin në vazhdim; 1) edukimi i të rinjve në fushën mjedisore, manaxhimit e mbetjeve, funksionimi i qendrës si hapësirë social-kulturore për pasurimin e kohës së lirë të rinisë, fokus në edukimin mediatik të të rinjve (përdorimi i kanaleve të infomacionit për të tejçuar mesazhin mbi çështje relevante). Temë e rëndësishme tangent me nismat në qendër ka qënë edhe ajo e përpjekjeve për barazi gjinore duke u reflektuar në aktivitete si manifestime për kauza të rëndësishme që kanë tronditur jetën në vend (rasti i përdhunimit në grup të 15 vjeçares nga Mirdita) apo vënia në skenë e shfaqjes së parë teatrale të qendrës.

Kjo periudhë ka shërbyer për të konsoliduar bashkëpunimet me institucionin arsimor më të madh në qytet, Gjymnazin “Hydajet Lezha” duke përmblusur orët e shërbimit komunitar për mbi 70 të rinj të këtij institucioni e ndërtuar kështu një ‘precedent’ e eksperiencë pozitive të qendrës si ofrues shërbimesh. Të rinjtë kanë vlerësuar angazhimin e kontributin në disa vepra të një rëndësie të veçantë për ta siç ka rezultuar rehabilitimi i disa këndeve të harruara në Lezhë ndër të tjera.

Po ashtu, një moment i rëndësishëm ka rezultuar të jetë qëllimshmëria e organizatës për të marrë nën tutelë çështjen e manaxhimit të mbetjeve në Bashkinë Lezhë, përpos bashkëpunimit me hope të kësaj të fundit. H.A.N.A u fokusua në këtë çështje duke marrë shkas nga zbatimi i një projekti më mbështetjen e një donatori në Tiranë (Lëviz Albania) por sidomos nxitur nga dëshira për të marrë përsipër një mision sfidues jashtë “zonës së rehatisë” së të qëndruarit brenda limiteve të gjër-atëhershme të qendrës për të zbatuar.

Gjatë kësaj periudhe, organizata ka qënë duke u munduar të gjejë mundësi për të kontribuar në qëndrueshmërinë e saj në të ardhmen, duke qënë se mbështetja e EED ka qënë një garanci e fortë vijimësie për periudhën e implementimit të projektit të mbështetur por mbetet nevoja për të vijuar rrugëtimin pa EED në të ardhmen e afërt.



Nuk kanë munguar përpjekjet për kontakte me aktorë të ndryshëm kombëtarë e ndërkombëtarë përmes përgjigjeve të thirrjeve të lançuara nga këta të fundit, apo kërkesave për kontakte të drejtpërdrejta. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane të Luksemburgut i është përgjigjur pozitivisht kontaktit tonë duke i dhënë qëndrës mundësinë e zbatimit të një projekti në vlerë më të madhe se ai i pari. Ndërkohë që përgjigje tjera priten së shpejti, qëllimi i organizatës është që nën asnjë rrethanë të mos shpëkusë ciklin e shërbimeve të ofruara si qender rinore, duke qënë hapur dhe aksesueshëm për rininë së pari.

Gushti ka qënë një periudhë më e avashtë zbatimi për shkak të përkimit me sezonin e pushimeve i cili pas shpëputjeve të vitit të shkuar, ka qënë shumë më aktiv në turizëm duke bërë që pjesëmarrja fizike në qendër të reduktohet ndjeshëm, për tu rikthyer sërish në Shtator sigurisht. Në tërësi, periudha Maj-Gusht 2021, mund të quhet për H.A.N.A si një periudhë e dyzuar mes zbatimit intensiv e planifikimit strategjik për muajt në vijim, duke marrë në konsideratë edhe refleksione e mësimet të caktuara nga e kaluara dhe se ekziston një mundësi e fortë që qendra të mos gëzojë në çdo moment përkrahjen institucionale bashkiake apo institucioneve të caktuara publike që nuk mirëpresin qasjen kritike. Kjo bën që të lindë nevoja që H.A.N.A të forcojë pozicionin e saj të pavarësisë e autonomisë në të ardhmen, pavarësisht mbështetjes institucionale publike.


Shtator – Dhjetor 2021

4 muajt e fundit të periudhës së raportimit vjetor për vitin 2021 janë mbështetur nga Fondi Evropian për Demokraci dhe kanë qënë intense njëloj si në pikun e zbatimit të segmentit kohor prej 2 vitesh (20f20 – 2021). Janë realizuar 54 aktivitete, evente dhe/ose produkte gjatë kësaj kohe dhe ka pasur një të kuptuar të konsoliduar nga ana e stafit por edhe komunitetit tanimë për qendrën. Periudha e fundit e zbatimit të projektit “Veprime të Përbashkëta për një Rini Pro-Aktive” ka përkuar edhe me një rritje të njohjes së ekzistencës së qendrës H.A.N.A përtej Lezhës, si një organizatë dhe qendër rinore lokale, e vetmja e llojit të saj në Lezhë.

Qëndrimi i organizatës me partnerët është po ashtu më i vendosur dhe i pjekur përse i përket ofertës së saj në tryezën e bashkëpunimit.

Thënë kjo, fokus të veçantë gjatë kësaj periudhe ka vijuar të kenë 4 drejtimet e programit të caktuar që në fillim të vitit dhe në vijimësi të 2 fazave të mëparshme; edukimi mediatik, demokracia e angazhimi në vendimarrje, barazia gjinore dhe mjedisi.

Në përmbyllje të vitit raportues mund të thuhet se është përmbushur synimi për të ofruar rinisë Lezhjanë një buqetë aktiviteteve e mundësish për angazhim e pjesëmarrje kanalizuar përmes një qendre rinore duke marrë trajtën e ofruesit të mirëfilltë të shërbimeve rinore në Lezhë. Qendra gjatë kësaj kohe është fuqizuar dhe ka lidhur partneritete me aktorë të rinj të shoqërisë civile në disa prej drejtimeve të programit. Kështu, janë lidhur 2 marrëveshje për ngritjen e një modeli edukimi mediatik me 2 organizata mediatike serioze dhe të pavaruara në vend (Qendra për Gazetari Cilësore dhe Faktaje.al); 1 marrëveshje me një organizatë kombëtare (qendra Act for Society) për ngritjen e klubeve rinore për diskutimin e normave gjinore në vend; lidhjen e një marrëveshjeje për zbatimin e një cikli leksionesh mbi demokracinë si dhe turnamenti debati me të rinjtë e shkollave 9-vjeçare të Lezhës me ministrinë e



çështjeve të jashtme dhe Evropiane të Luksemburgut; ka vijuar zbatimi i marrëveshjes me Bashkinë Lezhë për zbatimin e modelit të diferencimit të mbetjve në burim si dhe aktiviteteve tjera në fushën e mjedisit sipas një marrëveshje me Leviz Albania.

Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve janë arritur mbi 120 të rinj si përfitues e pjesëmarrës të drejtpërdrejtë dhe është ndërtuar një marrëdhënie më e fortë besimi me ta, e gjithashtu duke shtuar numrin e të rinjve që frekuentojnë qendrën për herë të parë.

Gjatë kësaj kohe ka qënë e nevojshme që qendra të kërkojë për mënyra e burime të të ardhurave për të siguruar qëndrueshmërinë e saj në të ardhmen, pra, për vitin 2022 e në vijim. Fatkeqësisht, përpjekjet në këtë drejtim nuk kanë qënë të suksesshme. Aktualisht qendra nuk ka një suport të garantuar për të mbuluar kohështirjen e të paktën vitit 2022. Projektet aktuale përfundojnë në muajin Shkurt 2022 nga Dhjetori 2021 i parashikuar në marrëveshje fillimisht, përmes një zgjatjeje kohore pa efekte financiare të kërkuar nga qendra për njërin projekt (Leviz Albania) ndërsa në 17 Shkurt sipas kontratës me donatorin MPJ Luksemburg.

Kjo periudhë raportimi shënon konsolidimin e plotë të qendrës në fushën e shoqërisë civile në Shqipëri e sidomos në Lezhë pasi njihet e pranohet tanimë si një ofrues shërbimesh rinore i mirëfilltë dhe unike në Lezhë përse i përket sferës së shoqërisë civile.


Të rinjtë që kryesisht frekuentojnë qendrën janë të moshës së shkollës së detyrueshme apo fakultative (shkollë e mesme) duke qënë se në Lezhë ka një normë të lartë të migrimit apo imigrimit të të rinjve dhe moshat më të mëdha të tyre janë osë në universitet, ose duke jetuar jashtë Shqipërisë ose duke kërkuar aktivisht mënyra për të ikur dhe kanë interes të ulët në përfshirje. Me përpjekjet e bëra nga qendra për të afruar të rinjtë mbi 18 vjeç është arritur që të afrohen në evente sporadike si event me folës të ftuar, kohë sociale e argëtimi, por ka pasur sfida për të garantuar dedikimin e tyre në evente të vazhdueshme dhe në seri. Megjithatë, qendra vlerëson se të punuarit me të rinjtë e moshës nën 18 vjeç, është një mënyrë e mirë për të siguruar që këta të rinj të marrin baza formimi ndryshe kur të rriten, duke vlerësuar efektet e angazhimit vullnetar e aktivist në një strukturë të shoqërisë civile.

2. Mësime, Sfida & Mundësi

Janar – Prill 2021

Një prej sfidave gjatë periudhës në fjalë ka qënë situata e shkaktuar nga pandemia. Pjesa më e madhe e stafit dhe bashkëpunëtorëve të ngushtë të qendrës u infektuan gjatë muajve Janar-Shkurt 21 çka e bëri zbatimin sfidues prej nevojës së karantinimit në kohë fluksi pune.

Trysnia e marrëdhënies me donatorët (gjatë kësaj periudhe H.A.N.A ka pasur 3; EED, MFA Luksemburg dhe Leviz Albania) ka rezultuar sprovë me përgjegjësi të shumëfishta për stafin por ka sjellë edhe benefitin e madh të një anëtareje të re në skuadër që tanimë është një vlerë e shtuar për qendrën. Nevoja për të zbatuar një kalendar të ngjeshur, zbatuar me grupime të ndryshme të rinjsh sigurisht që ka rritur shifrat e pjesëmarrjes duke zgjeruar rrezën e ndikimit të qendrës nëpër Lezhë e më gjërë (Mirditë e Kurbin, të rinj që frekuentojnë shkolla publike/jo-publike në Lezhë frekuentojnë edhe qendrën). Gjatë këtyre 4 muajve, 31 të rinj janë rekrutuar nga shkolla dimërore, 65 nga projekti me fokus mjedisor



financuar nga Leviz Albania dhe mbi 70 të rinj që kanë frekuentuar programin bazë të qendrës me mbështetjen e EED (klubi “Bëhu Burrë”, Teatri Social, Këndi Social i Eventeve, përfshirja në procesin zgjedhor etj). Pjesëmarrja dhe variancat gjinore janë përmirësuar pasi më shumë djem kanë marrë pjesë gjatë kësaj faze në eventet e ndryshme të qendrës. Gjykojmë se në këtë fazë qendra ka arritur edhe nivelin më të gjërë të shtrirjes në komunitet dhe influenca e të rinjve frekuentues ka ndikuar që bashkëmoshatarë të tyre të bëhen pjesë. Po ashtu, disa marrëveshje me 3 shkolla në Lezhë kanë rritur ndjeshëm numrin e frekuentimit.

Sfidë madhore tanimë është perspektiva e të ardhmes dhe nevojës jetike për qëndrueshmëri. Është e paevitueshme të mos mendohet për të ardhmen pas mbështetjes së EED, duke nxitur pikëpyetje por duke marrë edhe nxitje e inkurajim nga komentet pozitive të marra këto kohë për horizonte të reja. Sidoqoftë, në momentin aktual viti 2022 mbetet shqetësim për të siguruar garancinë e programit me të njëjtat burime njerëzore. Përpjekje po bëhen për konceptimin e projekt-propozimeve për burime potenciale suporti brenda dhe jashtë vendi, kryesisht brenda.


Maj – Gusht 2021

Një sfidë e kësaj periudhe ka rezultuar nevoja për burime njerëzore të përgatitura për të avancuar një mision aktivisti. H.A.N.A preferon punësimin e të rinjve nën 30 vjeç por kriter kryesor përveç moshës është parë të jetë mendësia dhe i kuptuari i personit i reflektuar në stil jetese dhe sens iniciative. Një aktivist i/e cila nuk zmbreset nga sfidat, është i/e hapur për të mësuar e rritur, ka zhdërvjelltësinë për tu përshtatur, kreativitetin për të udhëhequr të rinjtë në terrene të reja angazhimi, në dallim nga nismat konvencionale në nivelet e vullnetarizmit pasiv.

Ka qënë ndër barrierat kryesore, gjetja e njerëzve të tillë që të asistojnë me zbatimin cilësor të programit duke i marrë kohë bordit të organizatës për ti trajnuar e përgatitur. Fatkeqësisht, nuk është e lehtë të formësohë idealet e një profesionisti qoftë edhe të ri dhe njëkohësisht të zbatosh me të njëjtin ritëm programin. Organizata kërkon profilin e profesionisti të ri që nuk stepet nga paragjykimet e stereotipet por i lufton ato në mënyrë pro-aktive me nisma e ide, në vënd të të qënit fanatik të dogmave fetare e duke u frenuar nga ato; që ka inicitativën për të zbatuar aspekte programatike me supervizim minimal; që gjeneron ide që e ushqejnë programin i cili tashmë ka një trajtësim të mirë-përcaktuar se ku synon. Për shkak të shumë rrethanave objektive e subjektive, ambicies vetjake e mundësive ekonomike rinia e diplomuar nuk ka pasur ekspozimin më të mirë të mundshëm ndaj rritjes e eksperiencës profesionale e aq më pak në fushën e shoqërisë civile në Lezhë.

Po ashtu sikurse, është i natyrshëm synimi i qendrës për të pasur personel që kontribuon secili në pasurimin e programit dhe gjetjen e mënyrave të qëndrueshmërisë së tij. Kjo nuk ka ndodhur dhe ka qënë barrë e bordit të organizatës edhe gjatë kësaj kohe së bashku me nevojën për të manaxhuar prezencën virtuale të qendrës, që është edhe një mënyrë e rëndësishme informimi të publikut e palëve të interesuara për punën e qendrës por sidomos edhe e rekrutimit të të rinjve. Punë e cila merr kohën e vet.

Një nevojë e evidentuar është po ashtu edhe ajo parimeve kryesore të brumosura në lidhshpirtin e organizatës për të prioritetizuar, deleguar me sukses e kuptuar në kohë reale nevojat e skuadrës ndonëse



jo gjithmonë të artikuluar nga anëtarët e saj, por shpesh të perceptueshme. Është e rëndësishme që trysnia e të drejtuarit të mos bjerë në një individ për të funksionuar gjërat siç pritet, dhe kjo bëhet e mundur kur ka një standart të caktuar profesionalizmi dhe mendësie e intuïte aktivizmi tek anëtarët. Multi-tasking është një nevojë e padiskutueshme e lidhshpimit dhe është i mësuar por edhe sfidë e vazhdueshme ndarja e kohës me sukses ndërmjet suportit të stafit, planifikimeve javore e mujore e atyre në afat-gjatë, kërkimit e shfrytëzimit të mundësive për rrjetëzim me donatorë potencialë e bashkëpunëtorë.

Shtator – Dhjetor 2021


Kjo periudhë është shoqëruar me sfida duke qënë se ka përfaqësuar fundin e një epoke të caktuar të qendrës, pikërisht vetëdijen se mbështetja buxhetore nga EED është drejt fundit. Ka pasur tentativa të shumta për të kërkuar suport për programin e qendrës në vijimësi por janë hasur sfida domethënëse. Ka pasur një të kuptuar optimist megjithatë nga ana e drejtuesve të qendrës duke qënë se veçanërisht gjatë vitit 2021 ka pasur një numër të konsiderueshëm vizitash dhe interesi të shfaqur për ta vizituar e mësuar për veprimtarinë e saj ngas shumë aktorë vendas e të huaj të agjensive donatore në vend të tilla si OSBE, UN, Ambasada Britanike, Delegacioni i BE etj. Organizata ka tentuar të parashtrojë ndërhyrje të ardhshme për mbështetje të cilat gjatë këtyre vizitave janë parë me interes, megjithatë pa sukses. Sidoqoftë përpjekjet vijnë pasi H.A.N.A ka ndërtuar programin e saj në mënyrë të tillë që të ketë potencialin e qëndrueshmërisë edhe pa projekte të veçanta që sjellin resurse financiare, ndonëse kjo nënkupton ritme më të ulëta zbatimi dhe fluks të ngadalësuar aktiviteteve pasi zbatimi i përditshëm do të duhej të mbështetej në punë vullnetare dhe jo e paguar e njerëzit kanë nevojë të ndjehen të stimuluar financiarisht për të mbuluar shpenzimet e tyre të jetesës.

Gjatë këtyre 4 muajve zbatim, janë krijuar baza të mira të eksperiencës së konsiderueshme të qendrës në disa fusha të caktuara, veçanërisht atë mjedisore, duke u bërë precedent pozitiv në të ardhmen për të shtrirë në një rreze më të gjërë veprimi impaktin në këtë drejtim. Për herë të parë, H.A.N.A ka zbatuar një model të mirëfilltë ndarjesh në burim të mbetjeve urbane në bashkëpunim me institucionin e bashkisë dhe kompani manaxhimi të mbetjeve. Po ashtu, një mundësi e mirë për qendrën kanë qënë komunikimet e shumta me organizata lokale, kombëtare a ndërkombëtare, institucione publike lokale dhe prezencë diplomatike për të organizuar evente të përbashkëta duke dëshmuar kështu pozitën e përfortuar të qendrës në shoqërinë civile të Lezhës gjatë këtij 4-mujori të fundit të zbatimit. Shifrat e të rinjve pjesëmarrës në drejtimet e ndryshme të programit (media, demokraci, barazi gjinore dhe mjedis) janë rritur si pasojë e më shumë eventeve të qëllimta të orgaizuara në qendër e jashtë saj, në qytet e në zona rurale të Lezhës përmes partneritetit me drejtorinë arsimore dhe shkollat.

3. Balanca Gjinore dhe Çështje tjera Ndërsektoriale

Janar – Prill 2021

Qendra ka pasur sfida me afrimin e djemve në eventet e organizuara për shkak të interesit të ulët nga kjo kategori. Këtë periudhë ky tregues (përqindja e frekuentuesve djem) është rritur ndjeshëm. Bashkëpunimi me shkollat dhe të folurit rreth kësaj situate me stafet e shkollave dhe vetë të rinjtë por



sigurisht edhe koha e marrë për qendrën për të fituar popullaritet ndër të rinjtë ka bërë që të ketë rritje të ndjeshme të djemve duke shkuar në rreth 30% pjesëmarrje në nivel total. Patriarkalizmi dhe tërheqja e djemve dhe burrave nga eventet me natyrë sociale vijon të mbetet problem i shoqërisë shqiptare, veçanërisht rurale dhe sa më larg nga kryeqyteti të udhëtosh ndaj qendra po e mban gjithë kohës në vëmendje trajtimin e pabarazive gjinore. Një shfaqje teatrale po vihet në skenë dedikuar këtij fenomeni nga të rinjtë e qendrës, kretësisht origjinale. Klubi rinor “Bëhu Burrë” trajton dhunën me bazë gjinore dhe rolet gjinore në mënyrë të tillë që të përcjellë mesazhin se djemtë e burrat janë aleatë në këtë kauzë jo problemi pasi edhe mbi ta shoqëria ka vendosur trysni të padrejta. Tërheqjen, ndrojnë, skepticizmin, sjelljen agresive, fjalët e pista, nevrikosjen qendra e vë re tek djemtë shumë herë më tepër se te vajzat. Kjo i ka rrënjët në edukimin e presionet e rritjes së djemve për të qënë të fortë, të vendosur, burrëror dhe dominues. Janë sjellje të brumosura që në vegjëli e duhet një punë e koordinuar dhe e gjatë për ti shëmbur. Ndaj për momentin i gëzohemi fitoreve të vogla duke pasur nivelin më të lartë të pjesëmarrjes nga djemtë nga fillimi e gjër sot.

Maj – Gusht 2021

Ka më shumë djem që frekuentojnë qendrën si pasojë e të qënurit të qëlimshëm që në aktivitete që janë zhvilluar, është kërkuar një balancë gjinore nga shkollat (burimi kryesor i rekrutimit të të rinjve). Për shkak të tranzicionit të stafit në qendër dhe nevojave për ekzekutim të marrëveshjeve me zyrën arsimore në kuadër të orëve të shërbimit komunitar si dhe ndërhyrjes mjedisore, nuk ka qënë i njëjti fokus në volum i organizatës si në muajt më parë në aktivitete me fokus të mirëfilltë barazinë gjinore. Klubi “Bëhu Burrë” ka mbyllur një cikël dhe për shkak të volumit të punës nuk ka qënë e mundur të rifillojë ciklin tjetër gjat kësaj kohe. Po ashtu, një ndër ndërhyrjet më të suksesshme, teatri social, u përfundua me sukses, por nuk u replikua dot gjatë kësaj kohe për shkak se duhet një profesionist i motivuar financiarisht për të vijuar punën me ritme të kënaqshme. Gjë e cila nuk u mundësua dot gjatë kësaj periudhe. Nga ana tjetër, organizata është solidarizuar me përpjekjet e aktorëve tjerë të shoqërisë civile në demonstrime e manifestime kundër fenomeneve të dhunës ndaj vajzave e grave.

Shtator – Dhjetor 2021


Qendra ka një fokus të veçantë në çështjet gjinore duke qënë se barazia gjinore është një prej fushave të veprimit, manifestuar përmes klubeve rinore “Bëhu Burrë”. Klubi rinor “Bëhu Burrë”, ndonëse ngjan frazë ç’orientuese në tingull të parë, në fakt është një thirrje për të rinjtë për të konsideruar djemtë si aleatë në përpjekjet për barazi dhe paanësi në një shoqëri që i nxit ata të lundrojnë në ujërat e misogjinisë dhe pa-barazisë gjinore. Po ashtu, një tentative për të ri-dimensionuar termin “burrë” i cili në fakt, për qëllimin e këtij grupi, nuk përkon aspak me përkufizimin tipik me nuanca patriarkalizmi që trysnon djemtë e rinj për të qënë gjinia dominuese në forcë, arritje e kontribute. Gjatë kësaj periudhe zbatimi, ne kemi vijuar takimet me të rinjtë për të rrëzuar stereotipitë gjinore, ndonëse jo e lehtë. Në njërin prej takimeve tona, njëra nga vajzat e prezantoi shqen e saj duke përdorur ndër të tjera epitelin “e lëvizshme” dhe kur ju kërkua ta përkufizonte ajo tha që shoqëria përdor këtë term për vajzat rebele, që nuk bëhen palë me padrejtësitë dhe përpiqen t’i vendosin rregullat vetë se si duan ta jetojnë jeten e tyre. Ajo vetë nuk ishte dakord që shoqja e saj po bënte diçka të gabuar, por nëse për shoqërinë dhe mentalitetin ishte e gabuar, ajo duhej ta shihte si të tillë po ashtu, ndryshe do ta gjykonin edhe atë. Pra, shoqëria për ta përveçse përcakton rolet, përcakton dhe



Diskutimi i vazhdueshëm dhe më të njëjtët të rinj të këtyre çështjeve është vënë re se progresivisht ndikon për mirë në sulmin ndaj mendësisë patriarkale që rëndon mbi djemtë e rinj dhe veçanërisht mbi vajzat e reja të klubit. Dita ditës këta të rinj humbasin kompleksët e të diskutuarit të këtyre temave, më parë të patrajuara, ndonëse ndryshimi i të menduarit merr kohën e vet. Është e dukshme për stafin e qendrës se të rinjtë që frekuentojnë klubin apo edhe të rinjtë e ndërhyrjeve tjera, ku nuk mungon një kryqëzim i tematikave në fjalë me atë të roleve gjinore, janë më të lirshëm, më të shtensionuar e më të predispozuar për të konsideruar shopen dhe/ose shokun si të barabartë në diskutime, vendimarrje dhe çdo aspekt tjetër kognitiv e artikules.

Janar – Prill 2021

9/14



Megjithatë, rrjetet sociale Facebook dhe Instagram kanë qënë më të përdorurat, edhe në Twitter qendra ka një prezencë. Gjatë 4 muajve të raportimit, platforma Facebook dhe Instagram, hera herës edhe Twitter janë përdorur më së shumti për dukshmërinë dhe komunikimet e projektit/programit të Qendrës.


Shkolla dimërore ka rritur ndjeshëm frekuentimin e audiencave virtuale në Facebook e qendrës. Megjithatë të rinjtë frekuentojnë më pak këtë medium e më shumë Instagram. Mbetet fakt megjithatë që shumë institucione me të cilat kemi rënë në kontakt për qëllime të ndryshme të zbatimit, të përmendura në këtë raport, si në Lezhë apo në Tiranë e më gjërë, kanë ndarë se janë familjarizuar me qendrën nga rrjetet sociale dhe se kanë qënë të njohur me punën e bërë para se të njiheshin me stafin e saj. Një tregues se Facebook ka shërbyer për t'ju drejtuar një audience profesionistësh, institucionesh, mbështetësish potencial më shumë. Tani e në vijim, qendra do të mbajë vëmendjen të uebsajti dhe një prej rubrikave të tij (Blogu) për të bërë ndërlidhjen me vendodhjet e tjera në internet. Blogu i faqes së qendrës do të shërbejë për të shtjelluar më tej opinionet, qëndrimet, ngjarjet si nga stafi apo aktivistët.

Maj – Gusht 2021

Organizata është përpjekur të reflektojë sa më mirë punën e saj për audiencat, duke qënë e qëllimtë në dokumentimin e shpalosjen e tyre për publikun. Faqet në rrjetet sociale të organizatës janë përditësuar në mënyrë konstante si dhe është ri-parë e ri-modeluar faqja zyrtare e qendrës në rrjet duke marrë një pamje më dinjitoze, profesionale e të kompletuar. Shikueshmëria është e kënaqshme dhe vihet re se nga një organizatë e vogël e shoqërisë civile, e lançuar në start të pandemisë, ka një njohje të habitshme ndër organizatat jo-fitimprurëse në nivel kombëtar, institucionet publike, agjencitë ndërkombëtare prezente në vënd si dhe anëtarët e komunitetit. Kjo është vënë re nga kontakte të marra për bashkëpunime, vlerësime të marra në takime të ndryshme më ftesë si dhe analitikën e ndjekjes në rrjete sociale.

Shtator – Dhjetor 2021

Organizata është përpjekur të reflektojë sa më mirë punën e saj për audiencat, duke qënë e qëllimtë në dokumentimin e shpalosjen e tyre për publikun. Faqet në rrjetet sociale të organizatës janë përditësuar në mënyrë konstante si dhe është ri-parë e ri-modeluar faqja zyrtare e qendrës në rrjet duke marrë një pamje më dinjitoze, profesionale e të kompletuar. Shikueshmëria është e kënaqshme dhe vihet re se nga një organizatë e vogël e shoqërisë civile, e lançuar në start të pandemisë, ka një njohje të habitshme ndër organizatat jo-fitimprurëse në nivel kombëtar, institucionet publike, agjencitë ndërkombëtare prezente në vënd si dhe anëtarët e komunitetit. Kjo është vënë re nga kontakte të marra për bashkëpunime, vlerësime të marra në takime të ndryshme më ftesë si dhe analitikën e ndjekjes në rrjete sociale. Është parë me vend dhe e nevojshme që projekti të realizojë buletine, intervista klip e video te shkurtra ilustruese për të dokumentuar e ekspozuar punën tek audiencat me shpresën që më shumë të rinj por edhe mbështetës potencialë të vihen në dijeni për punën e qendrës.



5. Vlerësime Përfundimtare

Plot 212 evente, aktivitete e produkte janë përmbushur e realizuar në 24 muaj me një mesatare prej 10 eventesh në muaj duke përjashtuar fazën e parë që ka përkruar me ngritjen e ambienteve fizike të qendrës si dhe startin e pandemisë globale duke limituar zbatimin ndjeshëm.


Ky projekt që prej fillimit është parë si një mundësi e artë e qendrës për të zbatuar një vizion, atë të ngritjes së një hapësire fizike dedikuar rinisë në Lezhë, duke sfiduar status quo-në e mungesës së dedikimit institucional nga qeveria lokale apo qendrore për të investuar në infrastrukturë për të rinjtë. Në këtë kuptim është arritur qëllimi kryesor i projektit “Veprime të Përbashkëta për një Rini Pro-aktive”. Lezha tanimë ka një qendër rinore dhe ajo është e pajisur për të shërbyer si e tillë falë investimit të projektit. Në fillim të zbatimit të projektit, pritej që të pajisej qendra me infrastrukturën e duhur për të mbajtur aktivitete e pritur të rinj e po ashtu që kjo pajisje të rriste ndjeshëm numrin e frekuentuesve por ishte përtej parashikimeve pritja pozitive që ju bë qendres nga shumë njerëz e struktura duke i dhënë një lloj imazhi e dimensionesh shumë më të mëdha se sa citohej në hartimin e projektit (Shtojca D). Zbatimi i projektit e besimi i EED në një organizatë të vogël lokale në Lezhë bëri që H.A.N.A të prezantohej në mënyrë dinjitoze tek të rinjtë duke i nxitur ata ti afroreshin pasi në vitin e inaugurimit mbi 200 të rinj kanë frekuentuar qendrën ndonëse e prezantuar rishtazi si dhe në mes të një pandemie. Po ashtu, personeli i qendres është ndjerë i motivuar për të pasuruar projektin me shumë aktivitete tjera shtesë por të nevojshme për të përforcuar identitetin e qendres si një ofrues shërbimesh si dhe nga nevoja e munguar në qytet (e në të gjithë bashkinë) për evente ndërgjegjësuëse, kulturore e formuese. P.sh në Lezhë nuk ka një kinema dhe H.A.N.A falë pajisjeve të siguruara nga projekti e ka përmbushur këtë funksion për të rinjtë e Lezhës. Kurse për të rinjtë në edukim mediatik nuk janë dhënë më parë në Lezhë dhe H.A.N.A i ofroi. Të rinjtë kanë cituar se të qënurit vullnetarë e frekuentues të një qendre rinore i ka ndihmuar ata të eliminojnë frikërat e të folurit në publik e u ka dhënë avantazh në marrëdhëniet me të tjerët pasi janë bërë më të hapur në ndërveprim e tolerancë.

“Mundësitë që ofrohen nga qendra H.A.N.A nuk ofrohen tjetër kund dhe falë pjesëmarrjes time në programin e saj kam njohur miq të rinj disa prej të cilëve janë kthyer në shokët më të ngushtë që kam pasi na ka lidhur një interes i përbashkët.” – Klaudio 15 vjeç.

“Kur vi te qendra në ndjehem shumë rehat si në shtëpinë time pasi njihemi tashmë dhe jemi shumë të lirshëm me njëri tjetrin dhe idete që japim për aktivitete i kemi të përbashkëta e nuk zihemi cilën ide të zbatojmë.” – Keslin, 14 vjeç.

“Është mirë kur ke diçka ndryshe për të bërë të cilën s’ke nevojë të shkosh në Tiranë apo Shkodër ta kërkojsh si p.sh të marrësh pjesë në një orë poezie, të shohësh një shfaqje teatrale apo të bësh një kurs për të cilin do më duhej të paguaja shumë lekë nëse nuk do më ofrohej falas te H.A.N.A.” – Desaida, 19 vjeç.

Personeli i qendres ka përfituar jashtë mase shumë eksperiencë gjatë këtyre 2 viteve zbatim duke qënë se qendra është hapur nga e para dhe asnjëri nuk ka pasur eksperiencë në manaxhimin e një OJF të re apo aq më pak qendre rinore. Projekti ka lejuar fleksibilitetin për të mësuar gjatë rrugës e përshtatur aktivitete apo menduar të rinj që i kanë shtuar vlerë qendres në një moment të caktuar kohor, si p.sh të mos vazhdohej me më shumë kurse në tregimtari e multimedia po të kalohej në teatrin social dhe ngritjen e një trupe amatore teatri ndër të rinj si një mënyrë për të provuar e eksploruar çfarë funksion më mirë. Mbarëvajtja e qendres ka bërë që stafi të ftohej në evente të ndryshme si pjese e shoqërisë civile, të




ndante rrugëtimin e qendres, të rrjetëzonte me shumë palë që më parë nuk i njihje duke mos frekuentuar të njëjtat qarqe. Këto njohje janë bërë shkas shpesh herë për shkëmbim eksperiencash për stafin por edhe për pasurim të qendres me aktivitete. Eksperienca e përfutur në manaxhimin e administrimin e një qendre rinore është ndër sukseset më të mëdha pasi për 2 vite mbështetje financiare pogramatike që ka pasur qendra, stafit nuk i është dashur të angazhohet në përpjekje për të siguruar fonde e mbijetuar në një kontekst të vështirë viti pandemik por kanë qënë të fokusuar në rritjen e saj dhe gjetjen e mënyrave për të shtuar impaktin tëk të rinjtë dhe aktorët bashkëpunues.

Gjykojmë se kemi arritur të përmbushim objektivat e ngritjes së strukturës rinore të parë në bashki duke e bërë atë të qëndrueshme e aktive duke qënë se ky ka qënë objektivi kryesor fillestar. Jemi të kënaqur me mbarëvajtjen e qendrës dhe rrugën që ajo ka ndjekur për të ardhur gjër në këtë stad ku mund të konsiderohet e gatshme për një stad tjetër, atë të të qënurit e qëndrueshme për të ardhmen. E në këtë pikë qëndron një frikë e caktuar duke qënë se shoqëria civile në Shqipëri ekziston në një kontekst shumë të brishtë, së pari përse i përket një opinionit zhvlerësues tek njerëzit si jo eficientë e së dyti sepse ka një numër tejet të madh organizatash që operojnë në vend prej kohësh, disa me një kontribut të madh e disa tjera dëmtues jo vetëm për veten por edhe për OJF tjera për shkak të etikimit të njerëzve si “shoqatat janë njëllot”, duke e bërë shumë të vështirë e tejet kompetitiv procesin e gjetjes së mbështetësve brenda Shqipërisë (në agjensi të ndryshme ndërkombëtare që financojnë shoqërinë civile.

Në rastin e H.A.N.A ka ndikuar pozitivisht serioziteti në punën e marrë përsipër, jo thjesht si projekt, por si entitet i ri në vend, një sens përgjegjësie para njerëzve, të rinjve e institucioneve të ndryshme për të mbajtur fjalën e dhënë që Lezha do të ketë qendrën e parë rinore tashmë; së dyti ka ndikuar për mirë pasionin për kauzën i themeluesve të cilët kanë braktisur një karrierë në progres për t’ju dedikuar mbarëvajtjes së qendres. Duke qënë të përkushtuar pa pushime në fundjava apo orë të gjata gjatë javës, e gjitha sepse në fund të ditës ka qënë edhe mision jete e një ëndërr prej kohësh ajo e ngritjes së një strukture rinore. Të qënurit pjesë e një rrjeti mbështetësish (jo domosdoshtmerisht financiar) duke ndarë sfida e duke u inkurajuar së bashku ka ndihmuar në motivimin e nxitjen për të ardhur me ide të reja angazhimi e eventesh në qender. EED ka ndikuar që H.A.N.A të krijonte një rreth miqsh në Tiranë i cili më pas ka ardhur duke u zgjeruar vetvetiu e natyrshëm.

Sfidë ka qënë shpesh herë edhe qëndrimi me raste antagonist i institucioneve shtetërore, si p.sh i bashkisë e cila ndonëse jo duke e shprehur haptaz por duke e nënkuptuar me ndonjë mos-prezencë apo mangësi në përkushtim institucional në raste si ai i pilotimit të një modeli të ndarjes së mbetjeve në burim apo vizitave njohëse nga të rinjtë ku është marrë pozicion qortues e akuzues nëse/kur të rinjtë kanë kërkuar llogari në mënyrën e tyre. Duke pasur një imazh të mirë të ndërtuar të qendres, kjo sfidë është tejkaluar duke mos gjetur zgjidhje të përhershme por duke “tërhequr e mos këputur” marrëdhënien.

Sfidë tjetër ka qënë gjetja e të rinjve (apo më të rritur) të përgatitur e të përshtatshëm e përputhshëm me misionin e qendrës për ti rekrutuar e cila është pasqyruar disa herë në raportimet e mëparshme. Gjetja e profesionistëve është e vështirë pasi ose lëvizin drejt Tiranës ose jashtë Shqipërisë dhe është një problem i konstatuar prej kohësh që në qytetin e Bashkinë e vogël të Lezhës mungojnë profesionistët. Largimi për një 1 vit i njëres prej themeluesve të qendrës për specializim të mëtejshëm në një shtet tjetër e ka vëathtërsuar akoma më shumë situatën dhe mund të konsiderohet një sfidë e konsiderueshme




e kaluar ajo e përqëndrimit të punëve kryesore në pak duar. Mungesa e standartit si dhe e të kuptuarit të mendësisë së zhvillimit rinor dhe punës me një qendër rinore tek të kontraktuarit e herë pas hershëm kanë riskuar seriozisht ngadalësimin e ritmeve. Megjithatë, jemi përpjekur të ruajmë cilësinë dhe kreativitetin e sensin e iniciativës sa ka qënë e mundur.

6. Ndryshimi Madhor i Arritur

Ndryshimi kryesor i arritur është ngritja e qendrës rinore që më parë mungonte në Lezhë si strukturë, një ëndërr e themeluesve prej shumë kohësh por e pamundur për tu realizuar pa mbështetjen e EED duke qënë se nevoja e burimeve njerëzore dhe materiale të nevojitura e bënte natyrën e mbështetjes së nevojshme si strukturore, një lloj suporti financiar që donatorët tradicional nuk e ofrojnë. Në më pak se 3 muaj, pajisja dhe transformimi i një mjedisi bosh 250 m² në një hapësirë të pajisur mirë për të zhvilluar evente të ndryshme sociale, kulturore e zhvillimore e për më tepër mundësia për të pasur burime njerëzore në dispozicion për plot 2 vite të garantuar për ta manaxhuar atë, ishte pikërisht nxitja më e madhe e mundshme për të arritur këtë ndryshim madhor. Duke pasur këtë mbështetje, e gjithë vëmëndja e personelit ka qënë për të reflektuar, planifikuar e zbatuar nisma sa më strategjike e tërheqëse për rininë Lezhjane, pra, prezantim dinjitoz e ndryshe nga shumica e OJF-ve lokale pa kapacitete njerëzore e as administrative të cilat pësojnë goditje imazhi që në krijim e për pasojë kanë rendiment të ulët. Për H.A.N.A ishte ndryshe dhe kjo ka bërë gjithë diferencën. Ka shumë të rinj që frekuentojnë qendren që mund të artikulojnë qartazi një ndryshim në jetën e tyre për shkak të frekuentimit tanimë të qendrës H.A.N.A ku kanë kanalizuar të gjithë kohën e tyre të lirë.

Sot ndjehemi krenarë të përfaqësojmë një strukturë të kompletuar, me një konsolidim ndër shoqërinë civile e publike të Lezhës, me shumë eksperiencë të faktuar të akumuluar dhe me një rrjet të gjërë bashkëpunëtorësh e të njohurish. E gjitha kjo falë besimit që u vu përmes projektit për të cilin raportohet. Ndër 2 vite dinamike, shumë eksperiencë të përjetuara kanë bërë që H.A.N.A të fitojë vetë-besim për të synuar plane më ambicioze, duke synuar tanimë të kalojë nga objektivi i parë madhor (ngritja e një strukture serioze dhe ndikuese në Lezhë) tek objektivi i rradhës që është konsolidimi i një fokusi programatik ku të bëhet progres i qartë e të ndryshohet një politikë vendore, një mendësi e një grupimi a të arrihet ndonjë bashkëpunim ndikues në ndryshimet e synuara. P.sh. fokusi i qendrës në politikat mjedisore në Lezhë të avancojë me përmbushjen e standartit ligjor të manaxhimit të mbetjeve duke limituar përqindjen e mbetjeve të dërguara në landfill; apo, fokusi i qendrës në ngritjen e një tradite pa barriera të një shkolle dimërore të aktivizmit rinor; ngritjen e qëndrueshmërinë e një trupe amatore të teatrit social ndër të rinjtë që kanë talente që nuk i shprehin dot ndryshe; qëndrueshmërinë e klubeve rinore ku diskutohen e luftohen stereotipitë gjinore etj.

Ndoshta është e vështirë të shprehet me fjalë krahasuar me të përjetuarin në realitet të ndryshimeve për të cilat flasim por mund të thuhet se nuk ka qënë ndonjëherë më e lehtë për ne si themelues, të përshkruajmë një arritje pa qënë nevoja të përzgjedhim fjalët e duhura (për shkak se arritja nuk flet dot vetë) se sa në rastin e ngritjes së qendrës tonë rinore në Lezhë si dhe kontributit të EED. Nëse më shumë agjensi donatore do të kishin të njëjtën qasje nxitjeje të organizatave lokale apo kombëtare për të vënë në jetë një vizion të tyre në vënd të një liste të paracaktuar aktiviteteve sipas një fokusi të caktuar e jo-fleksibël të donatorit, pa dyshim do të kishte një imazh më të mirë të shoqërisë civile në Shqipëri dhe sidomos arritjeve të tyre si organizata apo individë kontribues. H.A.N.A ka pasur suport nga donatorë të tjerë si Ambasada Amerikane në Shqipëri, Ambasada Suedeze në Shqipëri, Leviz Albania, Delegacioni i BE



në Shqipëri e së fundmi MPJ e Luksemburgut e megjithatë gjithë çka kemi arritur përmes tyre ka qënë vënia në jetë e një ndërhyrjeje brenda e prej qendres rinore; pa EED nuk do të kishte pasur një qender rinore (ose jo një që tërheq vëmëndjen). Falë kësaj, ne jemi vizituar të kureshtuar nga institucione që nuk e kishim menduar kurrë se mund të qëllonim në një dhomë bashkë e aq më tepër të kenë ardhur me nismë të tyre për të vizituar e mësuar për H.A.N.A e planet e saj. Flasim këtu për ambasada të ndryshme (U.S, Suedi, Austri), organizata ndërkombëtare (OSCE, UN Albania, Friedrich Ebert Stiftung, EU Delegation, Europe House ndër të tjera) e madje deri tek kreu i misionit të vëzhgimit të zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri e cila shprehu interes nga fjala e përçuar nga stafi i OSCE për qendrën duke e parë atë si me rëndësi për rolin e luajtur në vëzhgimin e zgjedhjeve në Qarkun e Lezhës.

Besmira Lekaj, Drejtues Ekzekutiv, 21 Janar 2022

Raporti i dorëzuar nga

(Emri i plotë, titulli, nënshkrimi dhe data)